



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 92 Prot.

Tiranë, më dt. 20.02 2018

VENDIM

Nr.82 dt. 20.02.2018 .


Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 20.02.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Ndërtimi i Hec Kapiti” në Qarkun Kukës, me subjekt aplikues “ALBINMINE” sh.p.k.
2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture: “Banesa e Rustem Shahinit, fshati Osmane Bicaj”, Qarku Kukës.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
1. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Mirela Kumbare Fursh



SEKRETAR LKKR

Arta Dollani